

**Informim javor për median**  
(23 shtator 2021; 14:30)  
**Dhomat & Zyra Administrative**

Mirë se vini në informimin e dytë javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës ku do t'ju ofrojmë informacion përmbledhës të përditësuar mbi proceset gjyqësore dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Ditën e hënë, filloi me dhënien e dëshmisë dëshmitari i parë i Prokurorisë në gjykimin e Salih Mustafës.

Për dëshmitarin janë miratuar masa mbrojtëse në gjykatë, ku ndër të tjera përfshihet ndryshimi i pamjes dhe i zërit si dhe përdorimi i një pseudonimi.

Dëshmia e tij vazhdoi përgjatë javës ku dëshmitarit iu bënë pyetje nga prokurori, nga avokatja që përfaqëson nëntë viktimat pjesëmarrëse dhe nga ekipi mbrojtës i të akuzuarit. Dëshmitarit i bënë pyetje edhe gjykatësit. Dëshmitari i dytë i Prokurorisë pritet të fillojë dëshminë e tij këtë pasdite.

Ditë e martë, Trupi Gjyqësor dha një urdhër që autorizonte z. Mustafa të ndjekë procesin gjyqësor nga distanca me anë të videolidhjes nga objekti i paraburgimit.

Urdhri parashtron në mënyrë të qartë se z. Mustafa do të përfaqësohet gjithmonë nga avokati i tij në sallën e gjyqit dhe do të ketë mundësinë të udhëzojë avokatin përmes një kanali komunikimi të posaçëm. Dje, z. Mustafa u konfirmoi gjykatësve se mund ta ndiqte procesin gjyqësor dhe të konsultohej me avokatin e tij.

Urdhri nuk cenon të drejtën e z. Mustafa për të marrë pjesë fizikisht në seanca gjyqësore, nëse dëshiron.

Gjithashtu, urdhri nuk cenon as kompetencën e gjykatësve për të urdhëruar z. Mustafa që të marrë pjesë fizikisht në çdo seancë ku gjykohet e domosdoshme prania e tij fizike apo kur parashihet në Rregullore.

Seancat gjyqësore në çështjen *Mustafa* do të vazhdojnë nesër, të premtën, si dhe të hënë e të martën e javës së ardhshme.

Javën e shkuar mbrojtësi i z. Mustafa bëri me dije planin e tij për të dhënë deklaratë hyrëse pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar.

Lidhur me çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti sot paradite konferencë për ecurinë e çështjes.

Seanca të tilla organizohen rregullisht për t'u dhënë mundësinë Prokurorit të Specializuar dhe ekipeve të Mbrojtjes që t'i bëjnë të njohura Gjykatësit të Procedurës Paraprake çështje që mund të kenë si dhe për t'i dhënë informacion të përditësuar mbi stadin e përgatitjeve për gjykimin konkret.

Gjatë konferencës së paradites së sotme për ecurinë e çështjes *Shala* u diskutuan një mori temash, ku ndër të tjera përfshihej ecuria e hetimeve nga Prokuroria dhe nga Mbrojtja, si dhe procesi që njihet si "nxjerrja e materialit".

Nxjerrja e materialit është detyrim për Prokurorin e Specializuar për t'i ofruar Mbrojtjes provat në të cilat synon të mbështet për të provuar akuzat e tij.

Gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një urdhër gojarisht për ZPS-në që të dorëzojë dosjen paraprake jo më vonë se data 28 janar 2022. Dosja paraprake përmban argumentet dhe provat që synon të përdorë Prokurori i Specializuar për të provuar akuzat e tij.

Lidhur me çështjen e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, dëshiroj t'ju bëj me dije se të premten e shkuar Trupi Gjyqësor nxori një vendim lidhur me zhvillimin e procesit gjyqësor, i cili është planifikuar të fillojë më 7 tetor.

Së fundi, lidhur me çështjen kundër z. Thaçi dhe të bashkakuzuarve, sikurse mund të jeni në dijeni, javën e shkuar u organizua konferenca për ecurinë e çështjes, ku palët bënë me dije disponueshmërinë e tyre për konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes, e cila aktualisht është parashikuar për në fund të tetorit.

Një gazetar pyeti pse Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk po ndjek penalisht krimet e dyshuara të luftës të kryera nga pala serbe. Zëdhënësi u përgjigj se Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione më vete dhe të pavarura, dhe se gjithçka që lidhet me hetimet është brenda fushës së përgjegjësisë së ZPS-së.